

NJOFTIMI I KONTRATËS

I Autoriteti Kontrakt

Seksioni 1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia e Tiranës
Adresa Bulevardi "Deshmoret e Kombit"
Tel/Fax 00 355 4 22 56 799
E-mail prokurimet@tirana.gov.al
Faqja e Internetit www.tirana.gov.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qendror

Institucion i pavarur

Njesi e Qeverisjes Vendore

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Lloji i Kontratës

Punë

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

Objekti i kontratës: "Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës" "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 4"

Bashkia e Tiranës në rolin e "Autoriteti Kontraktor", fton Operatorët Ekonomikë në një procedurë ndërkombëtare Koncesioni/ Partneriteti Publik Privat për projektimin e detajuar dhe zbatimin e ndërtimit të katër objekteve arsimore në Zonën Tirana 4, mobilimin dhe mirëmbajtjen e tyre të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, mbikqyrjen dhe kolaudimin në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këto dokumente tenderi dhe me kushtet e kontratës. Kostoja e vlerësuar e projektit është 1.427.925.976 (një miliard e katërqind e njetëzet e shtatë milion e nentëqind e njetëzet e pesë mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në lidhje me shlyerjen e vlerës së investuar nga koncesionari faktin se koncesionari do të likujdohet për një periudhë kohore prej 7 vitesh nga

momenti I dorëzimit të objektit , gjithashtu ka parashikuar rimbursim për vlerën në kohë të parasë pra një marzh fitimi maksimalisht 6,28 % në vit për vlerën e mbetur. Koncesionari do të përballojë me të ardhurat e veta të gjithë investimin për projektimin ndërtimin mobilimin paisjen me laboratore, mirëmbajtjen, mbikqyrjen dhe kolaudimin si dhe vënien në funksion të tyre. Objektet arsimore duhet të ndërtohen si dhe të jenë funksionale në një afat kohor prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.Pas ndërtimit dhe vënies në funksion të objekteve arsimore , koncesionari/PPP do të mirëmbajë objektet për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare. Pas përfundimit të ndërtimit , Autoriteti Kontraktor do I paguajë koncesionarit/PPP një shumë të caktuar vjetore deri në përfundim të plotë të shumës së investuar.

Autoriteti Kontraktor do të zbatojë procedurën e hapur në pajtim me nenin 22 të ligjit nr.

125/2013 , I ndryshuar “Për Koncesionet dhe Partneritetit Publik Privat”. Autoriteti kontraktor do të marrë parasysh vetëm ofertat e atyre operatorëve ekonomikë apo Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, të cilët kanë kaluar kufijtë minimalë, të përcaktuara në kriteret e kualifikimit.

Janë përcaktuar 3 tipe kryesore shkollash, për Zonën Tirana 4 janë parashikuar gjithësej 4 shkolla, nga të cilat 2 shkollë nga Tipi 4, 1 shkollë e Tipit 2 dhe një shkollë e Tipit 1.

Me ndërtimin e objekteve arsimore në Zonën Tirana 4, objektivi i Autoritetit Kontraktor është të zgjidhë problemet të cilat janë evidentuar si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të shkollave në Bashkinë Tiranë.Me ndërtimin e këtyre objekteve arsimore , në Tiranë nuk do të ketë më shkolla të mbushura mbi kapacitetin e tyre normal apo shkolla që zhvillojnë mësimin me dy turne.

Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një sipërfaqe prej 29351.5 metra katrorë vendosur përkatësisht: Dy objekte arsimore janë vendosur në njësinë Administrative Nr.8, një object arsimor është vendosur në njësinë administrative nr.2 dhe nje objekt arsimore në njësinë Administrative Dajt.

Koncension/PPP për kontratën është i hapur për operatorët ekonomikë si dhe Bashkimet e operatorëve Ekonomikë të çdo vendi të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara me poshte.

1. **Forma e kontratës:** Koncesion/Partneritet Publik Privat (PBOTM)
2. **Burimi i financimit :** Bashkia Tiranë dhe Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë(Autoriteti Kontraktor)

2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja e kontratës PPP të Koncensionit do të jetë 7(shtatë) vite e 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.

2.4 Vendndodhja e objektit te kontratës:

Njësia Administrative Nr.2 dhe Njësia Administrative nr.8 dhe Njësia Administrative Dajt

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës nr. 9.

3.2 Sigurimi i Ofertës (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor) :

Operatori Ekonomik në një procedurë koncesioni/partneritetit publik privat, paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është e barabartë me 2% të vlerës së parashikuar të projektit ose në shumën prej 28.558.519 (njetete e tete million e peseqind e pesëdhjete e tete mije e peseqind e nentembdhjete) lekë pa TVSH.

3.3 Ne zbatim te pikes 7-te, te VKM-se nr.150, date 22.03.2007 “Per Organizimin dhe funksionimin e Agjensise se Trajtitit te Konçesioneve”, i ndryshuar me VKM Nr. 191, datë 13.03.2012, i cili parashikon, Konçesionari fitues duhet te paguaje per llogari te Agjensise se Trajtitit te Konçesioneve, detyrimin si me poshte vijon:

a) për projektet koncesionare deri në 5 000 000 (pesë milionë) euro, shuma e pagueshme është 5 000 (pesë mijë) euro.

b) për projektet koncesionare mbi 5 000 000 (pesë milionë) euro deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 10 000 (dhjetë mijë) euro.

c) për projektet koncesionare deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milion) euro shuma e pagueshme është 20 000 (njetetë mijë) euro.

ç) për projektet koncesionare mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milion) euro shuma e pagueshme është 30 000 (tridhjetë mijë) euro.

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës:

E hapur X	E kufizuar negocim	Me me shpallje paraprake
------------------	-----------------------	------------------------------------

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Nr.	Kriteri	Rezultati Maks.	Pragu Minimal/ Rezultati Kalues
TC1	Ideja e përgjithshme dhe koncepti i projektit	5	1

TC2	Zgjidhja e tipologjisë arkitektonike të shkollave <i>-plan-vendosja e objektit në terren</i> <i>-marëdhënia me kontekstin urban dhe hapësirën publike</i> <i>-marrdhënia mes hapësirave të jashtme e të brendshme</i>	10	3
TC3	Zgjidhja e organizimit të funksioneve të parashikuara <i>-zgjidhja e ofruar për organizimin funksional</i> <i>-zgjidhja planimetrike dhe drita natyrale</i> <i>-skema e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuar</i> <i>-integrimi i kopshtit me shkollën 9 vjecare</i>	10	3
TC4	Konceptimi i shkollës së qendër komunitare	10	3
TC5	Teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë	5	1
TC6	Materialet e përdorura	10	3
	KRITERET TOTALE TEKNIKE	50	
FC1	Oferta ekonomike për projektimin, ndërtimin, mobilimin dhe mbikqyrjen	30	
FC2	Oferta ekonomike për mirëmbajtjen deri në fund të kontratës	5	
FC3	Oferta ekonomike për marzhin e fitimit	15	
	KRITERET TOTALE FINANCIARE	50	
	TOTALI	100	

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data:16/01/2018 Ora 11:00 :

Vendi:www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data:16/01/2018 Ora 11:00

Vendi: www.app.gov.al

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, qe paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave:300 (treqind) ditë

4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip **X** Anglisht **X**
Tjetër _____

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë:

Nëse Po

	Po	Jo X
Monedha	_____	Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DSK/PPP tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DSK/PPP para blerjes së tyre.

5.2¹ Vlera e tarifës që duhet të paguhet nga operatori ekonomik në rast të një ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik: _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

5.3 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e DSK/PPP)

Kujdes: Dokumentacioni I cili do te ngarkohet ne faqen e app-se si (studimi I fizibilitetit, detyrat e projektimit, etj) I cili do ti bashkelidhet dokumentave standarte te koncesionit eshte referues(orientues) per operatoret ekonomike pjesmarres ne proceduren e koncesionit/PPP

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 24/11/2017

¹ Shtuar me VKM Nr. 401 date 13.5.2015